



Tiranë, në 11.06.2012

NJOFTIM PËR SHTYP

Mbi mbledhjen e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar, 5 qershor 2012

Në datën 05.06.2012, në Ministrinë e Financave u zhvillua mbledhja e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF). Mbledhja u kryesua nga Ministri i Financave dhe në të morën pjesë Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, drejtues të tjerë të këtyre institucioneve dhe të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si edhe personeli ndihmës.

Sipas programit të mbledhjes, GKSF diskutoi fillimisht mbi gjendjen e sektorit bankar dhe vlerësimin e rreziqeve të mundshme. Ndonëse veprimtaria e sektorit bankar u vlerësua e qëndrueshme, GKSF konstatoi se rreziqet në mjedisin rrethues ku zhvillohet veprimtaria bankare janë shtuar, edhe për shkak të zhvillimeve më të fundit politike dhe ekonomike në Greqi.

Në këtë kuadër, GKSF vlerësoi mundësitë e ndikimit të krizës greke mbi ekonominë dhe sistemin tonë financiar. Nga analiza, u konstatua se janë disa kanale përmes të cilave kriza greke mund të ndikojë në ekonominë e vendit, duke përfshirë marrëdhëniet e tregtisë, dërgesat e emigrantëve në afatin e mesëm, investimet e huaja me origjinë nga Greqia, si edhe krijimin e pritshmërive negative nga ana e agjentëve ekonomikë dhe publiku. Përmasat e ndikimit të mundshëm kanë një shkallë të konsiderueshme pasigurie, por GKSF vlerësoi se ekonomia ka fleksibilitetin e nevojshëm për të përballuar goditje të mundshme. Nga ana tjetër, kapitalizimi dhe likuiditeti i sektorit bankar janë në nivele më të larta se e njëjta periudhë e vitit të kaluar, falë edhe rritjes së kapitalit e të aktiveve likuide nga disa banka në muajt e fundit, në vijim të kërkesave mbikëqyrëse. Për këtë arsye, sektori bankar dhe bankat me kapital grek që veprojnë në vendin tonë vlerësohen të qëndrueshëm ndaj goditjeve të supozuara. Në vijim edhe të rekomandimeve të mbledhjes së mëparshme, GKSF theksoi rëndësinë që së bashku me industrinë bankare, autoritetet të vijojnë punën për të identifikuar të gjitha përmirësimet e

nevojshme ligjore dhe rregullative, të cilat zhvillojnë më tej aftësinë e tyre për të trajtuar rreziqet në veprimtarinë bankare, në mënyrë të harmonizuar dhe efektive.

Në vijim, GKSF u njoh me rivendosjen në funksionim të grupit ndërinstitucional për trajtimin e kredive me probleme, me pjesëmarrjen e autoriteteve publike dhe të industrisë bankare. Për shkak të rëndësisë së kësaj çështjeje, GKSF theksoi nevojën që grupi i punës, duke përfituar edhe nga asistenca e disponueshme prej Bankës Botërore, të përparojë me shpejtësi në identifikimin e drejtimeve kryesore ku mund të përmirësohet kuadri ligjor, rregullativ dhe operacional dhe mënyrën e realizimit të tyre, me qëllim që të krijohet një mjedis më nxitës ku kreditorët dhe debitorët të zgjidhin shpejt detyrimet mes njëri-tjetrit.

GKSF diskutoi edhe rreth gjendjes së likuiditetit në treg dhe financimit të nevojave të operatorëve të tregut. Duke u ndalur më gjatë në shpërndarjen e likuiditetit dhe në financimin e nevojave të Qeverisë, GKSF vlerësoi se ato janë plotësuar pa probleme të veçanta nga ana e operatorëve të tregut. Për pjesën tjetër të vitit, kërkesat për financim të qeverisë pritet të jenë më të ulëta dhe plotësimi i tyre pritet të jetë më i lehtë. Burimet e financimit në lek dhe valutë mund të përmirësohen nëse realizohen objektivat për privatizimin e disa ndërmarrjeve shtetërore që veprojnë në fushën e energjetikës. Sidoqoftë, GKSF theksoi që edhe në administrimin fiskal nevojitet të vlerësohen rreziqet që vijnë prej pasigurisë që ekziston në rritjen ekonomike, dhe të realizohen veprimet e nevojshme për të përshtatur nivelin e të ardhurave dhe të shpenzimeve publike.

Në përfundim, GKSF-ja planifikoi që mbledhja e ardhshme të zhvillohet në muajin shtator të vitit 2012.